



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1028 Prot.

Tiranë, më datë ____ . ____ .2021

VENDIM

Nr. 393, datë 14.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.07.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së *Z. Arben Spaho* për rinovimin e licencës individuale R.P. 89 në projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në kategorinë (A), nënkategoritë:
 - P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
 - P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
 - P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
 - P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
 - P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
 - P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

